



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 01/18
Prishtinë, më 28.03.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË PËRBASHKËT NË MES KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA
DHE KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Enver Hoti, Fikrim Damka, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Nga Komisioni për mbikëqyrjen e Financave Publike morën pjesë: Driton Selmanaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti dhe Albert Kinolli.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza – Ministër i Financave (tutje Ministri i Financave) dhe Lulzim Rafuna – Këshilltar i Ministrisë të Financave.

Pjesëmarrës tjerë: Albulena Mavraj – Gazetare nga Epoka e Re, Fjolla Uka – Hulumtuese nga KDI, Sylejman Blaku-Gazetar nga Kosova Sot, Amire Qamili- Gazetare nga BIRN, Halil Berisha – Gazetar nga Klan Kosova, Ismail Shabani-Gazetar nga Kosova Press dhe Albana Hajdari-Gazetare nga Kosova Post.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni(praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

1. Raportim i Ministrisë të Financave, z. Bedri Hamza, lidhur me Shpenzimet e Paparashikuara për vitin 2018.

Kryetari – theksoi se ky takim është thirrur pas raportimeve të fundit mbi mënyrën e menaxhimit të parasë publike me theks të vecantë për Shpenzimet e Paparashikuara. Në fakt në mbledhjen e Qeverisë më datë 09.03.2018, Kryeministri i Kosovës kishte parashtruar kërkesën për të ndarë 150.000 Euro për shënimin e 550 vjetorit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Ndaj kësaj kërkesë, Ministri i

Financave në po të njëjtën mbledhje kishte deklaruar se gjendja e rezervës është duke shkuar kah fundi dhe se institucionet tona duhet të kenë kujdes në mënyrën e shpenzimeve, rrjedhimisht shuma e kërkuar është përgjysmuar. Në vazhdimësi për shkak të interesimit publik ishte bërë e çartë se për vetëm dy muaj operim nga rezerva shtetërore prej 4.8 milion euro të parapara janë shpenzuar 2.8 milion Euro.

Realisht edhe gjatë muajve të fundit të vitit 2017 por edhe gjatë muajve të parë të vitit 2018, paratë publike janë shpërndarë pa ndonjë kriter të veçantë. Zoti Ministër, dua të shtroj disa çështje para prezantimit tuaj dhe shpresoj që do të marrim përgjigje. E para të sqarohet se cilat janë projektet në të cilat rezerva shtetërore është shpërndarë dhe do të ishte mirë të dinim se cilat janë ngjarjet e paparashikueshme që kanë ndodh këta dy muajt e parë? E dyta, kuptimi i kriterëve të përdorura mbi ndarjen e fondeve, pra a bëhet kjo ndarje krejtësisht në mënyrë arbitrare nga Qeveria dhe Kryeministri apo ka ndonjë proces vlerësues paraprakisht dhe mbi të gjitha këshillues? Dhe e treta, është e rëndësishme të dihen parashikimet dhe pritjet e Ministrisë dhe nevojat financiare që mund të dalin nga muajt e mbetur të këtij viti ku përfshihen edhe shpenzimet për Kostt-in a do të mjaftojë rezerva shtetërore dhe duke parë zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend më shumë se asnjëherë është parë dhe është shpërfaqur domosdoshmëria e pasjes së rezervës shtetërore për nevoja emergjente?

Ministri i Financave - po filloj paraqitjen time me konstatimin që këtë çështje e kam ngritur unë dhe është publike dhe jam këtu për sqarime para publikut dhe deputetëve të cilët e dinë se rezerva e Qeverisë nuk është në pozicion i cili e rrezikon stabilitetin makrofiskal, andaj sikurse ju edhe ne jemi të interesuar dhe të obliguar që të jemi të kujdesshëm ndaj çdo centi të parasë publike. Mirëpo nëse i referohemi historikut të shpenzimit të rezervës publike del që mesatarja e rezervave publike viteve të fundit është shpenzuar rreth 7-8 milionë euro, konkretisht në vitin 2016 janë shpenzuar 8 milionë euro, në vitin 2017 janë shpenzuar 6.9 milion euro.

Çështjen të cilën unë e kam ngritë ka të bëjë me parim, planifikim, procedura dhe me mesazh, paraja publike duhet të planifikohet mirë e duhet të shpenzohet kujdesshëm. Shumat e shpenzuara këtë vit janë: Flaka e Janarit është 54.850 euro, Përvjetori i Pavarësisë 600.000 euro, 100.000 euro për manifestimin e Epopesë së UÇK-së e cila ka qenë edhe viteve paraprake (shuma ndryshon nga viti në vit), 152.619 euro për Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, 120.000 euro për 800 familje të rrezikuara për Komunitetin Egjiptian, 50.000 euro për Komunitetet. Pesdhjetë përqind e rezervës është shpenzuar për adresimin e përkohshëm për çështjen e Kosttit dhe nuk dua ta adresojë askënd, mirëpo kjo Qeveri e ka trashëguar këtë problem, ku e dimë situatën që është krijuar pas çështjes që është ngrit nga Ombutspersoni si dhe e dimë që Zyra Rregullatore e Energjisë e ka dhënë një propozim, ku besoj që edhe Kuvendi duhet me marrë përgjegjësi, se Kostti ka kaluar nën përgjegjësinë e Kuvendit.

Shkyqja e linjave interkonektive të Kosovës nga vendet fqinje nënkupton izolimin e tërë sistemit elektroenergjetik të Kosovës e si pasojë e kësaj ky i fundit vështirë do të mund të operonte i izoluar për shkak të parametrave teknik në këtë rast të gjithë konsumatorët e Kosovës do të mbesin pa furnizim të energjisë elektrike, kjo do të cënonte funksionimin e vendit si konkluzion reputacioni i Kosttit do të rrënohej i cili tash është i cënuar seriozisht, do të pamundësonte Kosttit të filloj implementimin e marrëveshjes së kyqjes me Etnos.

Në pritje të ekzekutimit janë edhe disa çështje tjera ku një prej tyre është edhe për vitin e Skënderbeut ku brenda kësaj shume 250.000 euro janë ndarë për restaurimin e Kishës Katolike në Prizren e cila sipas sqarimeve që kemi marrë është e vetmja kishë në gjithë botën që e ka pikturën e Skënderbeut. Kriteret janë të qarta çdo gjë që ka kosto financiare shkon përmes Ministrisë së Financave. Apeloj që ne të jemi të kujdesshëm që ti planifikojmë gjërat me kohë, për ngjarjet të cilat ne i dimë që do të ndodhin çdo vit andaj duhet të planifikohet në kohë.

Kryetari - pyeti sërish a këshilloheni për këto mjete paraprakisht apo e merrni vesh në mbledhjet e Qeverisë? Në vitin 2017 ju thatë se janë shpenzuar 8 milionë euro të shpenzuara nga rezervat, a janë përfshirë edhe kostot e zgjedhjeve sepse kanë qenë dy pale zgjedhje? Sa i përket pagesës së Kosttit, kur duhet bërë pagesa tjetër dhe sa do të jetë vlera e kësaj pagese?

Driton Selmanaj - zoti Ministër në fakt po provoni me i marrë shembull vitet të tjera sikur dëshironi të relativizoni qasjen se si e ka pas kjo Qeveri këta tre muaj, ku prej periudhës 12 mujore për vetëm këta dy muaj e gjysmë është arrit të shpenzohet 50% e rezervës. Pyetja ime është kjo, meqenëse ju jeni një lloj kordinuesi i draftimit të Buxhetit, si është e mundur që shumica e parave që janë shpenzu deri tash prej rezervës për ngjarjet të cilat ne e kemi dit që kanë me ndodh, duke i përfshirë ngjarjet që i cekët e të cilat janë të natyrës së tillë që kanë kalendar? A ka kritere apo plane paraprake për çka mendohet me u shfrytëzë këto mjete apo gjithmonë lihen në rezervat dhe presim për kërkesat? Pra, a ka koordinim paraprak mes juve dhe ministrive të caktuara për këto tematika dhe mënyrën se si të shpenzohen këto para? I përmendët shpërndarjen e parave për komunitetin egjiptian dhe komuniteteve tjera, a mund të specifikoni adresimin e tyre sepse ne në muajin dhjetor kemi pas mbi 36.000 euro që janë ndarë për fëmijët e Leposaviçit për festat e fundvitit unë kurrë se kam kuptuar çfarë dallimi kanë fëmijët e Leposavicit me fëmijët e Rahovecit, Suharekës apo ndonjë komune tjetër dhe festë të Vitit të Ri kanë edhe fëmijët e qyteteve tjera! Realisht pyetja ime është, a mund të kemi më të detajuar dhe specifikuar se për çka janë shpenzu mjetet në vitin 2017 dhe si e keni mbyll vitin 2017, si dhe planet eventuale të cilat ju i keni se si ta rishikoni planifikimin e Buxhetit për vitin 2018?

Dardan Molliqaj - në bazë të asaj çka u tha sot dhe të interesimit që e kam pas për këtë çështje ne mund të konstatojmë që është një problem i përsëritur, pra një mënyrë jo parimore të menaxhimit të këtij zëri të shpenzimit, pra nga ajo çka u tha nga Ministri dhe nga raportet është çështje e disa qeverive që shpenzimet e paparishkueshme, shpenzohen për aktivitete që janë saktësisht të parashikueshme dhe shumë të vetëdijshme jo vetëm për Qeverinë por edhe për shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ajo që dua ta ngrit këtu është çështja e Kosttit, ku ne me Komisioni për zhvillim ekonomik e kemi pas një vizitë në Kostt dhe javën e ardhshme do të kemi një raport të ZRRE-së dhe nga ajo që kemi kuptuar gjendja në Kostt është alarmante. Ajo që kam kuptuar deri më tani qytetarët e Republikës së Kosovës kanë paguar 50 milionë Euro për shpenzimin e energjisë elektrike që ka ndodhur nga një pjesë e territorit të Republikës së Kosovës dhe ne e dimë që Qeveria e Kosovës e kaluara ka bërë një marrëveshje të energjisë me shtetin e Serbisë, dhe realisht e di se nuk është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e juaja sepse është e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por sigurisht që lidhet edhe me juve, dhe do të isha kureshtar me e kuptu se si parashikoni zgjidhjen e këtij problemi për shkak se me atë që kam kuptuar edhe shuma e mbetur e parave të paparashikuara për këtë vit është e pamjaftueshme nëse shkojnë të tërat në këtë problem?

Mendoj ajo që nuk po ndodh në Kosovë ende është përgjegjësia publike për dëme të tilla, sepse kjo dhe shpenzimet tjera, nuk është që ka ndodh një fatëkeqësi natyrore për të cilën nuk e kemi dit. Pra kemi të bëjmë për mosparashikimin e shpenzimeve të ditura dhe për çështjen e Kosttit edhe pse është përgjegjësi e Qeverisë së kaluar, edhe kjo Qeveri nuk e ka adresu fare, dhene tash si shtet dhe si shoqëri detyrohemi të paguajmë kosto të ndryshme të cilat janë edhe të padrejta por edhe të mëdha.

Ministri i Financave – është praktikë që kur të vijnë në Ministrinë e Financave departamenti i Buxhetit jep opinion secilës pikë a është kosto e paraparë brenda kufijëve buxhetorë dhe nëse është e rezervës ta jep gjendjen e rezervës dhe rekomandimin. Për pikat të cilat vendosen ne të ndryshme në mbledhjet e Qeverisë, Ministria e Financave nuk mundet me dhënë opinion me shkrim dhe rekomandim për çështjet të caktuara dhe duhet mendim edhe sqarim i Ministrit brenda mbledhjes së Qeverisë. Sa i përket shpenzimeve të rezervës për vitin 2017, ato do të jenë pjesë e Raportit financiar të i Shpenzimeve 2017, i cili do të dërgohet në Kuvend.

Sa i përket zgjedhjeve nacionale i kemi adresuar me procesin e rishikimit të buxhetit. Sa i përket Kosttit zgjidhja afatgjatë e këtij problemi është zbatimi i marrëveshjes për energji ku ne si Kosovë jemi duke u

dëmtuar dhe të gjitha zgjidhjet tjera janë afatshkurtra. Sa i përket ndarjes së buxhetit për komunitetet janë shpërndarë për rastet sociale. Ndërkaq zoti Molliqaj ngriti disa çështje me rëndësi, konkretisht marrëveshja për energji është jashtëzakonisht e domosdoshme të zbatohet dhe nëse në Prill nuk e adresojmë do të jetë çështje problematike si rezultat i kësaj brenda vitit mund të jetë shumë përafërsisht 10-12 milionë Euro që duhet të sigurohen për këtë çështje.

Enver Hoti - çështja e shpenzimeve që po bëhen nga Fondi i Rezervave me të drejtë është ngritur Ministri në Kabinetin Qeveritar që të ketë kujdes për kriteret, por çka do të doja nga Ministri që për planifikimin buxhetor 2019 të keni kujdes dhe të jeni të vëmendshëm, që organizatat buxhetore të bëjnë planifikimet e nevojshme dhe domosdoshme në mënyrë që mos të biem në situatë të kërkohet mjete shtesë nga Kabineti Qeveritar. Sa i përket Kostt-it i kemi pas për herë të parë për raportim vjetor financiar në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në bazë të raportit, ndër rreziqet që i ka parashikuar raporti është edhe mosrealizimi i marrëveshjes për energji elektrike, ngritja e linjës Kosovë-Shqipëri me një kreditim dhe sipas raportit që ne kemi pas këtu kemi has në atë që ka filluar edhe të rrjedhë debia. Prandaj, kjo është një masë shtesë që rëndon faturimin e qytetarëve dhe Qeverisë, kështu që ne kërkojmë përmes Kabinetit Qeveritar të jetë energjik dhe të kërkojë fuqishëm realizimin e marrëveshjes së energjisë. Ne kemi shtruar një pyetje këtu në Komision se a kanë marrë pjesë ekspertët në bisedimet teknike që janë zhvilluar për marrëveshjen e energjisë në Kostt, pyetje për të cilën nuk kemi marrë ende përgjigje.

Shqipe Pantina - kam dy shqetësime që do të doja ti ngrisja, e para sa i përket rezervave ndaj vendeve të cilat ato kanë kaluar kanë qenë pjesë e Komisionit për Buxhet në rishikim të Buxhetit pothuajse të gjitha kërkesat në formë të amendamenteve që vinin nga deputetët për projekte të ndryshme janë mbuluar nga rezervat, kjo praktikë është zbatuar deri më tani, mirëpo shpresoj që do të evitohet tani e tutje që rezervat të mos shpenzohen për çështje joemergjente, ndonëse për fat të mirë në këtë vit nuk kemi pas gjendje të tilla emergjente të mëdha. Megjithatë dua ta cekim që në disa vende në Kosovë ka pas vërshime ose në disa tjera shembull Istogu ka pas erëra të forta që kanë shkaktuar dëme ku për të cilat komunat nuk kanë kapacitet me i mbulu. Pra pyetja ime është, a ka Qeveria ndonjë plan me i mbështet këto raste?

Ndërkaq, çështja e dytë ka të bëjë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave, punët tona kryesore janë shqyrtimi i raportit të auditorit për institucionet publike e natyrisht një numër i tyre vijnë nga ministritë të cilat janë pjesë e Qeverisë, kështu që të kujdesen që paraja të shpenzohet siç është planifikuar dhe në përputhje me ligjet në fuqi. Një varg Ministrish në vazhdimësi kanë shkelje të njëjta për të cilat auditori u jep vërejtje dhe rekomandime, shkeljet e përmirësuar mirëkuptohen mirëpo kur kjo ndodh në vazhdimësi këtu diçka nuk është në rregull. Pra, cilat janë masat që ju si Ministri e Financave keni ndërmarrë deri tash apo nëse nuk keni ndërmarrë deri tash cili është plani juaj që t'iu jepen fund këtyre shkeljeve?

Safete Hadërgjonaj - unë dua të inkurajoj Ministrin të vazhdon me insistimin e tij që çështjet të cilat dihen paraprakisht të jenë pjesë e planifikuar në buxhet dhe ndoshta të insistoni që ngjarjet e caktuara të cilat duhet të jenë pjesë e buxhetit që të mos ketë më nevojë prej vitit në vit të përsëritet e njëjta gjë. Unë e di që duke njohur punën tuaj, profesionalizmin, angazhimin dhe menaxhimin që i keni bërë Financave Publike si në të kaluarën ashtu edhe tash e di që nuk do të lejosh të shpenzosh mjetet në mënyrë arbitrare, pa kriter dhe me dorë të lirë. Prandaj, e vlerësoj edhe ngritjen e çështjes të cilën e keni bërë në Qeveri si dhe duke u tërhequr vërejtjen të gjithëve që çdo shpenzim duhet të planifikohet paraprakisht. Sa i përket çështjes së Kosttit është e vetmja ndërmarrje publike e cila me ligj duhet ti raportoj Kuvendit, mirëpo Kuvendi nuk vendos për buxhetin e këtij institucioni do të thotë ka defekte të cilat janë përcjell me ligj dhe të cilat duhet ne deputetët të insistojmë që ta zgjidhim këtë problem. Unë e kuptova që ju e sqaruat këtu në lidhje me këto shpenzime meqenëse gjysma e këtyre shpenzimeve të cilat janë bërë brenda kësaj periudhe është pikërisht për Kosttin dhe për problemin e

moszbatueshmërisë së marrëveshjes, mirëpo ky është problem që është bartur nga e kaluara. Megjithëse një pjesë e mjeteve është ndarë pikërisht për komunitetet do të doja që ne si Kuvend ta luajmë rolin tonë të cilin e kemi sepse ne japim fjalën e fundit për buxhet që Ministria e Komuniteteve të fillojë ti trajtojë të gjitha komunitetet në mënyrë të barabartë.

Ne tani jemi 20 vite pas lufte nëse duhet për çdo vit të merremi me përvjetorë të ndryshëm që disa bëhen më mirë e disa më keq e kështu që ju hyjmë në hak edhe ngjarjeve të caktuara që kanë ndodh në të kaluarën. Qeveria duhet të hap këtë debat dhe të shikojë a duhet të festojmë për çdo vjet secilën ngjarje dhe nëse vendosim që për çdo vjet atëherë të bëhen pjesë e buxhetit që në fillim. Duke i parë këto shifra të cilat i theksuat që nuk rrezikohet buxheti dhe nuk po rrezikohet stabiliteti makrofiskal është rezerva e Ministrisë që duhet të adresojë çështjet specifike dhe unë problematike e shoh çështjen e Kosttit e cila kërkon trajtim më serioz dhe ndoshta duhet të involvohet edhe Kuvendi i Kosovës.

Driton Selmanaj - e kam një pyetje lidhur me një vendim që ka pasur Kryeministri i vendit ose Qeveria diku në vlerë 300.000 euro për rastin Kumanova , dua të di a është edhe kjo në kuadër të rezervave apo nga cilat kategori buxhetore janë marrë dhe janë dhënë ato mjete ?

Kryetari - çështja e Kostt-it po shëndërrohet një temë problematike për të gjithë, pavarësisht natyrës së dhe kohës kur ka lind problemi i cili duhet trajtuar tani. Mirëpo në qoftë se ne duhet paguajmë nga 1 milionë euro në muaj për afërsisht atëherë duhet nisim planifikimet e më hershme buxhetore për këtë çështje sepse brenda vitit do të shpenzojmë sic thatë ju deri 12 milion euro për energji elektrike të serbëve në Veri. Besoj se pajtohen të gjithë si rekomandim të dy komisioneve përshpejtimin dhe angazhimin të Qeverisë për të gjetur zgjidhje afatgjate për këtë punë sepse as nuk është e drejtë për qytetarët tjerë të Kosovës që megjithatë po e paguajnë energjinë në veri, përmes taksave të tyre por as që është zgjidhje e qëndrueshme sepse asgjë nuk na garanton që në fund të vitit nuk do të kemi prap një vit tjetër fiskal me 10-12 milion euro në vit sërish për të paguar energjinë në veri.

Albert Kinolli - atë që dua ta ngris është për çështjen e shpenzimeve ku u përmendën edhe komunitetet pakicë apo edhe në përgjithësi ku dua të fokusohem tek komunitetet tjera jo serbe. Ne si komunitete tjera na ka shkakto gjithmonë kokëçarje me rastin e ndarjes së mjeteve të cilat kanë qenë në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim. Prandaj, dua të dëgjoj edhe nga ju zoti Ministër që kur të bëhet planifikimi i buxhetit për vitin 2019, a do të kishte mundësi që komunitetet tjera jo serbe, të ndahet një fond i veçantë për shkak se 18 vite pas luftës komuniteti serb ende mbetet kushtimisht “komuniteti më i ledhatuar dhe komuniteti më i privilegjuar”, ndërkaq, komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian mbeten ende komunitetet më të margjinuar në Kosovë. Ne kemi qenë viktimë e të gjitha proceseve që ka kaluar Kosova, kështu që ky komunitet mbijetesën e tyre e siguron nga lëmosha, mbledhja e kanaqeve dhe janë taksapagues të rregullt si sa i përket shpenzimit të rrymës, të ujit ,të taksave, etj.

Ministri i Financave – sa i përket Kostt-it qëndrimi jonë si Ministri e Financave besoj edhe e Qeverisë që zgjidhja afatgjate dhe e drejtë është respektimi i marrëveshjes për energji dhe dua të besoj që me përkrahje edhe e vendeve tona mike e partnere kjo çështje me u adresu, përndryshe çfarëdo forme që paguhen është ngarkesë e padrejtë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sa i përket planifikimeve buxhetore edhe për organizatat buxhetore edhe në nivel qëndror dhe lokal e nëse i referohemi standardeve të kontabilitetit për me i vlerësu drejtë pasqyrat financiare janë të obliguara aq të ndajnë pozicionet edhe për kontekstet të mundshme gjuhësore e lëre më për dëme, vërshime e për çështjet tjera. Përndryshe ne i bëjmë pasqyrat financiare si dhe i prezantojmë të cilësdo organizatë buxhetore por standardet nuk i ka përmbush.

Sa i përket raporteve të auditimit secili rekomandim duhet të adresohet e kur ka të gjetura kanë edhe shkelje materiale besoj që ajo është objekt i përgjegjësive të veta. Sa i përket ekzekutimeve të buxhetit është bërë decentralizimi i tij ku kemi ligjin e buxhetit i cili na obligon të gjitha organizatave buxhetore në nivel lokal dhe qëndror dhe ata kanë mundësi me ekzekutu buxhetin e me i bërë pagesat, ku ata i kanë

qasje në sistem, ne i shohim dhe raportojmë ashtu siç i shohim, do të thotë nuk ka mundësi Ministria e Financve të ndikojë në një organizate buxhetore sepse është ligji. Sa i përket rastit të Kumanovës po flasim për familjet mjetet janë ndarë për familjet dhe i takon periudhës së vitit 2017 pra nuk është pjesë e vitit 2018. Ndërkaq për kodin e veçantë për komunitete buxheti jep mundësi në aspektin etnik dhe profesionalisht e brendshme është e mundshme me shku me racionalizim ku brenda secilit komunitet të shihet me planifikim se çka mund të bëhet.

Raportimin në Kuvend e shoh si ndihmë, nevojë që të rritet niveli i përgjegjësisë gjatë planifikimit buxhetor, të rritet niveli i disiplinës dhe të rritet niveli i transparencës së buxhetit.

Edhe një sqarim dua të bëjë lidhur me dallimin mes rezervës buxhetore dhe bilancit bankar ku rezerva buxhetore është një pozicion brenda buxhetit të Kosovës që zakonisht sillet rreth 5-8 milionë euro ndërsa bilanci bankar më datë 27.03.2018 është 390 milionë euro, ku kemi një rritje të parasë së gatshme në raport me fillimin e vitit rreth 33 milion euro, që nuk nënkupton që kjo gjendje do të na përcjell gjatë gjithë vitit sepse jemi në kohën kur ndoshta shpenzohen më shumë para se sa që mbledhen.

Kryetari - e dimë se as 7 milion dhe as 20 milion euro nuk e rrezikojnë stabilitetin makrofiskal, mirëpo rekomandoj të zgjidhet problemi i Kostt-it dhe të planifikohen shpenzimet paraprakisht për ngjarjet që e dimë se do të ndodhin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku